# Heroinë, municion luftarak dhe para, arrestohen tre trafikantët në Elbasan (Emrat)

31 Gusht, 2021 10:32



Madhësia e tekstit:

Policia e Elbasanit ka goditur një rast të shpërndarjes së drogave të forta në doza të vogla. Gjatë aksionit, policia ka arrestuar në flagrancë 3 shtetasit që posedonin dhe shpërndanin lëndë narkotike, përkatësisht shtetasit Ahmet Kushi, Aleksandër Hazizaj dhe Besmir Duka.

Gjithashtu, janë sekuestruar doza me lëndë narkotike heroinë, 3 aparate celular, një peshore e vogël elektronike, municion luftarak dhe para të përfituara nga shitja e lëndës narkotike.

**Njoftimi i policisë:**

Në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale të shpërndarjes së drogave të forta në doza të vogla, gjatë kontrolleve të shtuara për rritjen e parametrave të sigurisë, specialistët për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve të Paligjshme në DVP Elbasan arrestuan në flagrancë shtetasit:

Ahmet Kushi, 31 vjeç, Aleksandër Hazizaj, 39 vjeç dhe Besmir Duka, 32 vjeç, të tre banues në Elbasan.

Arrestimi i këtyre shtetasve u bë pasi në lagjen "5 Maji", Elbasan, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasve Ahmet dhe Aleksandër (vëllezër), shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale doza me lëndë narkotike të dyshuar heroinë, 3 aparate celular, një peshore të vogël që shërbente për peshimin e lëndës narkotike, një sasi municioni luftarak, kokrra të bardha të dyshuara si metadon dhe një sasi parash të përfituara nga shitja e lëndës narkotike.

**(BalkanWeb)**

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

**Etiketa:** arrestime | Elbasan | heroine

TË NGJASHME

Punëtori 55-vjeçar ra nga lartësia në vendin e punës dhe ndërroi jetë, arrestohet administratori i firmës
08 Shtator, 2021

Dhunoi gruan, arrestohet 38-vjeçari në Tiranë, në pranga dhe disa të tjerë të akuzuar për vepra të ndryshme penale
07 Shtator, 2021

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Kultivuan kanabis në Kryezi të Tiranës/ Kush është biznesmeni që drejtonte grupin, një prej të arrestuarve pendohet dhe pranon të bashkëpunojë me drejtësinë
08 Shtator, 2021

VIDEO/ Hyn për të 'blerë' në argjendari në Gjirokastër, shihni momentin kur hajduti vjedh byzylykun dhe e fut në xhep
08 Shtator, 2021

Përplasi me makinë 74-vjeçarin me biçikletë, arrestohet i riu në Shkodër
08 Shtator, 2021

EMRAT/ Kultivuan kanabis në Kryezi të Tiranës, 7 në pranga, mes tyre dhe një kryeplak. Sekuestrohen armë e municione
08 Shtator, 2021

VIDEO/ Gara shpejtësie në rrugën 'Migjeni', si ranë në grackën e policisë 5 drejtues mjetesh
08 Shtator, 2021

Kujdes, policia ju vëzhgon! Me shpejtësi skëterrë deri në 167 km/h, penalizohen shoferët rebelë, hiqen 25 patenta
08 Shtator, 2021

KATEGORIA VIDEO



Dashamir Shehi: Berisha non grata? Është çështje personale e tij. Nëse ligji s'e lejon futjen në Kuvend, KQZ të flasë
Osman Stafa | 08 Shtator, 2021

'Teatri Shëtitës' ringjall qendrat kulturore në rrethe, Kiço Londo: Kemi me shume festivale se shfaqje teatrore
Fatmira Nikolli | 08 Shtator, 2021

VIDEO/ Hyn për të 'blerë' në argjendari në Gjirokastër, shihni momentin kur hajduti vjedh byzylykun dhe e fut në xhep
08 Shtator, 2021

Parlamenti i ri, Nazarko: Pres një opozitë me qasje propozuese dhe denoncuese cilësore e korrupsionit. Kosova, të kërkojë nga SHBA përfshirje në dialogun me Serbinë
08 Shtator, 2021

"Vendi i dytë është i kapshëm", Altin Lala në "Sport News": Kombëtarja e ka vetë në dorë fatin
08 Shtator, 2021

EMRAT/ Kultivuan kanabis në Kryezi të Tiranës, 7 në pranga, mes tyre dhe një kryeplak. Sekuestrohen armë e municione
08 Shtator, 2021

Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT



DETAJET/ Vrasja e kandidatit për kryetar komune në Pejë dhe zyrtarit të PDK-së, dyshohet se viktimat qëlluan njëri-tjetrin me armë, i plagosur dhe...
08 Shtator, 2021



E rëndë në Tetovë/ Spitali përfshihet nga flakët, dyshohet se disa pacientë dhe mjekë kanë humbur jetën
08 Shtator, 2021



E rëndë në prag zgjedhjesh/ Dy të vrarë dhe një i plagosur, viktimat kandidati për kryetar komune në Pejë dhe zyrtari i PDK-së
08 Shtator, 2021



Hassan Ahud jep intervistën e parë si kryeministër: Epoka e gjakderdhjes në Afganistan ka përfunduar
08 Shtator, 2021



Dashamir Shehi: Berisha non grata? Është çështje personale e tij. Nëse ligji s'e lejon futjen në Kuvend, KQZ të flasë
Osman Stafa | 08 Shtator, 2021



Covid-19 në Maqedoninë e Veriut/ Mbi 700 raste pozitive dhe 24 viktima
08 Shtator, 2021

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb



© 2021 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.